



Prishtinë, 16.02.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1499\_2022

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, Nenin 30 dhe Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 par. 1 nënpar. 1.11, Nenin 4, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Dispozitat e Nenit 23 dhe Nenin 75 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 20.08.2021 për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja Interenergo D.o.o.-Kosova SH.P.K., adresa: Rr. Demë Ali Pozhari, Nr. 41, 51000 Deçan, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 16 shkurt 2022, nxori këtë:

## VENDIM

- I. VAZHDOHET Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike ndërmarrjes Interenergo D.o.o.-Kosova Sh.P.K, me numër licence ZRRE/Li\_56/16 për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 27 shkurt 2022 deri 26 shkurt 2027.**
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për Interenergo D.o.o.-Kosova Sh.P.K, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.**

## Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 20 gusht 2021 në formë elektronike dhe me 23.08.2021 përmes Administratës së Rregullatorit (Nr.506/21) ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike nga përfaqësues të ndërmarrjes Interenergo D.o.o.-Kosova Sh.P.K



- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
  - Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **Interenergo D.o.o.-Kosova Sh.P.K.**, me datë 25 janar 2022 ka njoftuar përmes gazetave palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtisë) me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
  - Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
  - Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
  - Pas dorëzimit nga kompania në fjalë të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas udhëzimeve të rregullatorit, aplikacioni është konsideruar i kompletuar, kështu që Bordi i Rregullatorit duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
  - Licenca e lëshuar me datë 27.02.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li\_56/16), do të vazhdojë të jetë e vlefshme edhe për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri më 26 shkurt 2027, dhe mund të vazhdohet, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës dhe plotëson kushtet për vazhdim licence, në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si dhe me dispozitat përkatëse të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë. Të gjitha dispozitat e licencës së lëshuar me datë 27.02.2017 mbulohen me Licencën e lëshuar përmes këtij Vendimi.
- III. Licenca për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike i lejon të licencuarit që të kryejë aktivitetin e sipërpërmendur të energjisë elektrike në Kosovë, në pajtim me Licencën dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi i dërgohet:**

- Të licencuarit **Interenergo D.o.o.-Kosova Sh.P.K**
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


**Bordi i Rregullatorit:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar, Anëtar

  
Lutfiye Dervishi, Anëtare

  
Geni Buçaj, Anëtar